

# **Politikani i Ri**

## **Fletore e Akademisë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike**

# Politikani i Ri

## Fletore e Akademisë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



**NATIONAL  
DEMOCRATIC  
INSTITUTE**  
FOR INTERNATIONAL AFFAIRS

Lejohet prezantimi, kopjimi dhe shpërndarja e librit në tërësi apo në pjesë, me kusht që: (a) materialet të përdoren duke i njohur USAID-it dhe NDI-së autorësinë e botimit, (b) ky libër do të shërbejë vetëm për përdorim informativ, jo-tregtar dhe personal, (c) të mos bëhen modifikime të këtij libri.

Ky libër u mundësua përmes mbështetjes së ofruar nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nën Marrëveshjen Bashkëpunuese (Cooperative Agreement) Nr. 182-A-00-04-00104-00 me NDI. Opinionet e shprehura në këtë botim janë të vetë autorëve dhe si të tilla nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID.

Botuar nga Shtëpia Botuese “PEGI”

Rruga e Elbasanit, Pallatet Fratari, Filipeu Nr.2, Tiranë

Tel: +04 374947

Fax: +04 374947

Përgatitur nga Dan Redford, Najada Tafili, Elton Stefani, Blerina Karagjozi

Faqosja: Erald Velmishi

ISBN: 99943-705-4-5



# Përmbajtja

• Parathënie	VI
• Dy fjalë për kontribuesit	VIII
1. Përse nuk funksionon shteti i së drejtës në Shqipëri? <i>Admir Sinamati</i>	1
2. Financimet e partive në zgjedhje dhe problemet <i>Artan Tujani</i>	4
3. Degët lokale të partisë <i>Kastriot Gurra</i>	7
4. Roli i Medias në Zgjedhje <i>Melsi Labi</i>	11
5. Transparenca e të ardhurave të partive politike <i>Genti Minarolli</i>	14
6. Pjesëmarrja e qytetarëve dhe roli i tyre në procesin zgjedhor <i>Mariela Hoxha</i>	16
7. Zgjedhje të lira dhe të ndershme <i>Korab Ndreu</i>	20
8. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin zgjedhor <i>Ermelinda Muho</i>	22
9. Përgatitja për fushatën elektorale <i>Albana Imami</i>	28
10. Fushatat zgjedhore zbulojnë skarcitetet e medias <i>Jorida Nonaj</i>	32
11. Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA)	38

# Parathënie

Një nga nismat e ndërmarra nga National Democratic Institute for International Affairs (NDI) është bashkëpunimi me partitë politike në Shqipëri, për nxitjen e demokracisë së brendshme në parti. Për këtë arsye, duke parë dhe interesin e madh që kjo temë ka pasur në qarqet politike në vend, menduam që këtë numër të revistës t'ia kushtojmë pikërisht këtij procesi. Demokratizimi i brendshëm i partisë është përfaqësimi i vërtetë i mendimeve të anëtarësisë.

Në realizimin e këtij botimi, kanë dhënë kontributin e tyre pjesëmarrës të disa partive të spektrit politik shqiptar. Ata kanë dhënë vlerësimet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me situatën aktuale brenda partive të tyre.

Në këto shkrime mund të gjeni mendime në lidhje me arsyet e mosfunksionimit të shtetit të së drejtës në vendin tonë; mënyrat e përgatitjes për fushatën zgjedhore; organizimi i degëve lokale të partisë; procesi zgjedhor; pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e zgjedhjeve dhe roli i tyre në këtë proces etj.

Një nga temat më me interes të trajtuara në këtë numër është financimi i partive politike sidomos gjatë fushatave zgjedhore. Shpesh dëgjohet që financat e partive janë një nga pikat më të nxehta në një fushatë zgjedhore, sepse fondet e padeklaruara mund të jenë gjithmonë një çështje e cila vlen të diskutohet. Për këtë arsye është theksuar dhe ideja e transparencës së të ardhurave në një parti politike, duke e vlerësuar si një domosdoshmëri për të ardhmen e politikës në vendin tonë.

Opinionet e shprehura në këtë publikim janë të vetë autorëve dhe nuk përfaqësojnë këndvështrimet e NDI.

Në këtë botim ne shpresojmë që të kemi mundësuar paraqitjen e një fryme të re në vazhden e botimeve në fushën e politikës.

Dan Redford  
Këshilltar i Lartë për Partitë Politike dhe Proceset Zgjedhore  
Elton Stefani  
Oficer Programi/Akademia për Udhëheqësi dhe Reformë Politike  
Najada Tafili  
Oficere Programi/Akademia për Udhëheqësi dhe Reformë Politike  
Blerina Karagjozi  
Asistente Programi/Akademia për Udhëheqësi dhe Reformë Politike

NDI/Shqipëri  
Maj 2005  
Tiranë

# Dy fjalë për kontribuesit



**Admir Sinamati**

Anëtar i Kryesisë së Forumit Rinor,  
Partia Demokratike

**Artan Tujani**

Sekretar i Përgjithshëm, Partia Lëvizja e  
Legalitetit



**Kastriot Gurra**

Anëtar i Kryesisë  
së Partisë Socialiste, Librazhd

**Melsi Labi**

Anëtar i Këshillit Kombëtar,  
Lëvizja Socialiste për Integrim





**Genti Minarolli**

Anëtar i Kryesisë së Forunit Rinor,  
Partia Demokratike

**Mariela Hoxha**

Anëtare e KDK-së,  
Lëvizja Socialiste për Integrim



**Korab Ndreu**

Anëtar i Këshillit Kombëtar,  
Partia Balli Kombëtar Demokrat



**Ermelinda Muho**

Anëtare e Këshillit Drejtues të Forunit  
Rinor, Partia Demokrate e Re



**Albana Imami**

Anëtare e Forunit Rinor,  
Partia Socialdemokrate



**Jorida Nonaj**

Anëtare e LRI,  
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim





# 1. Përse nuk funksionon shteti i së drejtës në Shqipëri?

*Admir Sinamati*

Prej kohësh kam kërkuar dhe po mundohem (duke u ballafaquar edhe me faktet e shumta të historisë dhe politikës) të bind veten se Shqipëria është një ndër të shumtat raste të tentativës për të konsoliduar shtetin dhe demokracinë. Nga e gjithë puna ime kërkimore (që vazhdon ende) dy janë rastet e ngjashme me atë që ndodh sot në Shqipëri.

E para thërret nga Lashtësia Romake, në shekullin e parë para Krishtit kur perandoria më e madhe e kohës u shkërmoq ngaqë perandori bleu votat e të urtëve.

E dyta është pak më e freskët, Gjermania e viteve 30, tentoi humnerën botërore pasi një grup deputetësh të asaj kohe po talleshin me regjimin. Kjo u bë shkas që brenda një kohe të shkurtër talljen ta përdorë njeriu më i mbrapshtë që ka njohur historia botërore dhe ta shndërrojë atë në katastrofën më të madhe humanitare. Duke uruar që diçka e përafërt të mos ndodhë kurrë në Shqipëri shpesh pyes veten. A funksionon shteti i së drejtës në Shqipëri? A jam unë një qytetar apo nënshtetas? Kush e ndërton shtetin garant?

Shpjegimet janë të shkurtra dhe të qarta. Para disa kohësh pata mundësinë të debatohet më një njeri shumë të rëndësishëm të fushës të së drejtës madje ai është edhe deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Në bisedë e sipër ai disa herë e përmendi shprehjen “*nënshtetasit shqiptarë*”. Fillimisht mendova se po fliste për të shkuarën. U tërhoqa shumë nga biseda e tij dhe koha foljore fliste për një të tashme të kryer. Ky politikan që dikur kishte dhënë

drejtësi në emër të diktaturës së proletariatit më mbajti një leksion të gjatë për të mirat e shtetit garant. O ç'tragjikomedi brilante! Megjithë kakofoninë juridike të këtij zotërie, u ndava nga ai njëkohësisht i lumtur dhe i shqetësuar. Isha i lumtur ngaqë ishte një person i vjetër në moshë dhe se ishte deputet i një partie tjetër. I shqetësuar, se ky person është një person me shumë rëndësi në jetën e asaj partie madje edhe i komisionit parlamentar të ligjeve. U mërzi ta jashtë mase sepse ky person që mbart në pozicionin e tij politik një ngarkesë të konsiderueshme të homologëve të tij është në grupin "famëkeq" të strukturimit të shtetit garant. Ai më quajti nënshkret, madje edhe veten ashtu e quajti. Mendova që ishte gabim në fjalëformimin, por kuptova që edhe logjika e tij kështu funksiononte. U ndava nga ky sharlatan me një trofe të humbur; atë të qytetarit. Humba edhe atë që vjen pas kësaj trofeje. Kërkova argumenta për të rrëzuar gjykimin e këtij zotërie, por ishte e pamundur. U tremba kur me një logjikë të përafërt funksiononte mendja e një mikut tim jo shumë të rëndësishëm në partinë time. Fatmirësisht i vjetër në moshë, fatkeqësisht deputet.

Tirania e mendimit komunist ka lënë gjurmë të thella në këtë brez të dështuarish. Për t'iu përgjigjur një shqetësimi kategorik, shpesh kujtoj shprehjen e gjyshes time të urtë tek më thoshte: "Nuk bëhet triko e re me penj të vjetër, por ajo që thuret quhet triko".

Shtetin garant e bëjnë ato që njohin më së miri filozofinë e votës së lirë, ato që nuk kanë ngarkesa nga ideologjia e diktaturës, ato që nuk mbushin kutitë e votimit, por që ftojnë njerëzit të votojnë në emër të kësaj kauze të shenjtë. Shtetin garant e bëjnë ata që garantojnë pasurinë më të madhe politike të qytetarëve, lirinë dhe votën e lirë. Por vota nuk dhunohet vetëm atëherë kur votohet për deputet apo drejtuesit lokal. Dhunimi është kthyer në praktikë pune në shumë parti politike në Shqipëri. Ato shkolla ku mendohet që do të dalin gardianët e mbrojtjes së shtetit garant po institucionalizojnë numërimin alla-stalinist të votës. Është provuar se pasojat që lindin nga votime të sforcuara brenda radhëve të partive që drejtojnë sot qeverinë shqiptare janë transmetuar tek militantët e tyre në bazë duke provokuar hapur rënien e sistemit të votës së lirë, madje edhe e kanë konsumuar këtë vepër katër herë me radhë. Kongreset maoiste nuk i lënë frymë demokracisë.

Ato e mbysin atë nga anoksia, intoleranca dhe antivlera.

A e shpëton sistemin politik parimi “një anëtar një votë”?

Them me siguri se po. Ja arsyet:

- Rrit mundësinë e përfshirjes në politikë të njerëzve seriozë me njohuri në fushën e filozofisë të së drejtës;
- Rrit mundësinë e rivalitetit dhe përsosmërinë;
- Rrit nivelin e drejtimit si rezultat i rritjes së besueshmërisë;
- Ngulit në mendjen e njerëzve logjikën që çdo votë ka forcë dhe vlerë;
- Mëson njerëzit të respektojnë dhe vlerësojnë peshën e votës;
- Në mënyrë analoge, anëtarin e partisë e transformon në qytetar të shtetit të së drejtës dhe jo në nënshtetas të nje regjimi tiranik.

Nëse arbitri mishëron dhe i përjeton çdo ditë, çdo natë të gjitha këto cilësi atëherë ai kontribuon për të krijuar bazën e shtetit të së drejtës, bazuar në konkurrencën e partive politike që filozofinë e së drejtës e kanë shndërruar në institucion mendimi dhe veprimi politik. Shpresoj që kjo formë e të bërit politikë të distancojë nga drejtimi i shtetit monstrat deputetë që përmenda më sipër. Zoti më ndihet!

## 2. Financimet e partive në zgjedhje dhe problemet

*Artan Tujani*

Kompleksiteti i një fushate zgjedhore nuk do të kishte përmasat e veta të natyrshme, nëse pjesë e saj nuk do të ishte edhe komponenti financiar. Vitet e fundit është vënë re një tendencë në rritje e rolit të financave në fushatat elektorale (shembujt janë të shumtë).

Është e panevojshme të shpjegohet se përse nevojiten dhe përdoren financat në një aktivitet të tillë, por është fakt se roli i tyre është bërë i pazëvendësueshëm dhe, hera herës, merr karakter primar, duke eklipsuar edhe elementë të tjerë të fushatës. Në thelb, funksionet normale të aktivitetit politik në përgjithësi dhe fushata elektorale në veçanti, nuk mund të kuptohen pa një faturë shpenzimesh. Pikërisht, për këtë aktivitet normal që është, në fund të fundit, edhe shprehje e zhvillimit të demokracisë, ligji parashikon: “Përveç fondeve nga buxheti, subjektet zgjedhore mund të përfitojnë për fushatën e tyre, dhurata nga persona fizikë ose juridikë privatë vendas, jo më shumë se 1 milion lekë, ose kundravleftën në sende apo shërbime. Ata deklarojnë (në përputhje me nenin 145/a të këtij Kodi), të gjitha dhuratat...”.

Gjithashtu, në nenin 145 (Shpërndarja dhe rishpërndarja e fondit për financimin e fushatës..., pika “b”), përcaktohet se “... 40 % e shumës së financuar ndahet ndërmjet partive të përfaqësuara në Kuvend...” Sidoqoftë fondet janë të pakta, por në raport me cilësinë e zgjedhjeve që janë zhvilluar deri më tani, opinionet se këto shpenzime janë të pajustificuara, marrin njëfarë vlere. Pamjaftueshmëria e fondeve rrit tendencën e grumbullimit të

fondeve jo publike. Rreziket që vijnë nga një veprim i tillë, janë të shumta dhe të natyrshme. Pikësëpari, partitë politike rrezikohen nga afrimi dhe ndikimi politiko-financiar që ushtrojnë bizneset formale dhe informale, të cilat shprehin afekcion të dukshëm pikërisht gjatë fushatave zgjedhore, për të formësuar lidhjet me politikën, me qëllim përdorimin e saj si koperturë për aktivitetet e paligjshme dhe përfitimin e beneficeve gjatë konkurrimit për akaparimin e fondeve publike.

Rrezikshmëria e këtij infiltrimi është gjithëkohore për shkak të financave të pamjaftueshme të partive, çka krijon kushte për nënshtrimin e tyre dhe kandidatëve ndaj biznesit gjatë fushatave zgjedhore dhe pas tyre, në formën e kundërvleftës dhe shpërblimit për financimet e dhëna gjatë “nevojës së politikës”. Një nga simptomat më të rrezikshme, të pranishme e lehtësisht të konceptueshme është fenomeni i blerjes së kandidimit me para. Dhe kjo imponohet natyrshëm sidomos kur, mëtonjësit e biznesit, për t’u angazhuar politikisht shpërfaqin ndikimin e tyre elektoral nëpërmjet mbështetjes që sigurojnë nga të punësuarit në bizneset e tyre dhe familjarët e të punësuarve.

Gjithashtu ata shprehin gatishmëri të hapur për të përballuar vetë shpenzimet e fushatës, madje edhe për financimin e fushatës së politikanëve influentë, që përcaktojnë vendosjen e kandidaturave të tyre në emër të subjekteve politike. Një nga veprimet administrative që favorizon rritjen e ndikimit dhe presionit të biznesit në kandidimin dhe infiltrimin në politikë, e më pas mundësimin e akaparimit të saj në vazhdimësi, është edhe zvarritja e lëvrimin të fondeve të planifikuara për fushatën zgjedhore të partive. Kjo manovër ka dëshmuar efikasitetin dhe ka rritur agresivitetin e biznesit drejt partive në vështirësi financiare. Pushteti gjithmonë ka krijuar dhe stimuluar qëllimisht pabarazinë në sasinë e fondeve të akorduara për partitë, duke stimuluar hapur partitë e koalicionit në pushtet ose të lidhura me pushtetin.

Mungesa e transparencës së financimeve gjatë fushatave zgjedhore, lehtëson përdorimin abuziv të fondeve me origjinë të dyshimtë, që rëndom shfrytëzohen për manipulime dhe votëblerje. Me ndikimin e drejtpërdrejtë të politikës, gjatë fushatave zgjedhore vërehet fenomeni i rritjes së tarifave dhe çmimeve të shërbimeve në mediat vizive. Kështu, spotet televizive të partive dhe kandidatëve, çuditërisht rriten me fillimin dhe acarimin e fushatave dhe fillojnë të

kushtojnë shumë më tepër sesa spotet e biznesit të emetuara në vazhdimësi. Kjo vështirëson bilancin finaciuar dhe rrit artificialisht koston e fushatës së partive të “varfëra” e kandidatëve të tyre, duke krijuar dhe thelluar pabarazinë financiare dhe mediatike në konkurrim, çka padyshim përkthehet në zvogëlim të rezultateve të pritshme, pasi i privon zgjedhësit nga njohja me programet individuale dhe partiake të subjekteve të “vogla”.

Të ndërgjegjshme për këto vështirësi, partitë e diskriminuara paragjykojnë që në fillim të garës dhe i nënshtrohen presionit të faktorëve negativë, çka manifestohet dukshëm edhe në rezultatet zgjedhore, pavarësisht nga cilësia e programeve dhe kandidatëve të tyre në raport me rivalët.

## 3. Degët lokale të partisë

*Kastriot Gurra*

Ajo që bie në sy në mënyrën e funksionimit, organizimit, drejtimit dhe menaxhimit politik të forcave politike në Shqipëri është ngjashmëria shumë e madhe që ata kanë me njëra-tjetrën si dhe një lloj i ngjashëm organizimi me atë të ish parti së punës. Megjithëse bëhet fjalë për dy sisteme të kundërta politike nga ai i partisë shtet në një sistem shumë partiak. Partitë e reja nuk kanë arritur të ndahen nga mënyra e vjetër e funksionimit. Për shkak të rëndësisë shumë të madhe që kanë partitë politike. Por edhe të një rëndësie të veçantë që atyre ua garanton Kushtetuta është shumë imediate mundësia e ndryshimit të formës dhe organizimit të këtyre partive.

Sigurisht që kjo mënyrë e vjetër funksionimi më shumë se kudo vihet re në degët lokale të partisë, të cilat megjithëse kanë arritur një lloj progresi janë akoma shumë larg të qenit parti vërtet perëndimore në kuptimin e organizimit, vendimmarrjes etj. Ky diferencim ndodh për shkak se duke qenë larg qendrave të vendimmarrjes politike, ato kanë shumë pak mundësi të jenë prezente në media, të lançojnë programe apo burime njerëzore etj. Por në fakt cilat janë problemet më të mëdha me të cilat ndeshen degët lokale të partive politike?

### **Decentralizimi**

Detyra e degëve të partisë në rrethe është që ato të mbajnë

kontakte të vashdueshme me anëtarët e partisë. Të marrin prej tyre opinione dhe ide për një veprim politik. Sa më të efektshëm, pasi anëtarët e partisë janë hallka e fundit që lidh një parti me votuesit. Kështu që mendimi i tyre është i një rëndësie të veçantë. Gjithashtu një udhëheqës i mirë lokal duhet të përcjellë në mënyrë korrekte direktivat e udhëheqjes qendrore për anëtarët e partisë, si dhe të interpretojë drejt efektin që kanë këto udhëzime tek anëtarësia e gjerë, si dhe të amortizojë sa të mundet. Kur këto udhëzime kanë efekt negativ, për të shmangur në këtë mënyrë përçarjen apo, fraksionimin e bazës së partisë çka do të sillte si pasojë një rezultat jo të kënaqshëm elektoral.

Sigurisht që momenti më i rëndësishëm për një parti politike është koha e zgjedhjeve, për pushtetin lokal apo qendror. Dhe përveç premtimeve elektorale, mesazheve, kontaktit me median sensibilizimi i anëtarisë dhe elektoratit për të marrë pjesë në votime dhe për të zgjedhur alternativën përkatëse, i një rëndësie të jashtëzakonshme është edhe përzgjedhja e kandidatit që do garojë për ngjyrat e forcës politike. Zgjedhja e kandidatit që do të përfaqësojë partinë në zgjedhje duhet patjetër të përfshijë anëtarësinë e partisë me qëllim që kandidati të testohet përpara se të votohet në elektorat. Ai duhet të bëhet objekt debati në strukturat vendore të partisë me qëllim që ato të zgjidhen për kandidatin që garanton fitoren.

Në pamje të parë duket sikur ndodh kështu, por në mjaft raste procedura është tjetër. Vetë partia funksionon në mënyrë të centralizuar ku pjesa më e madhe e vendimeve në qendër të saj, dhe ndodh që për shkak të mungesës së informacionit ose informimit të pasaktë, mosnjohja e kandidatëve ashtu siç janë në të vërtetë, vendimet e liderit të partisë, të jenë në kundërshtim me atë të bazës së partisë.

Për pasojë rezultatet në zgjedhje nuk janë ato që priten. P.sh. në zgjedhjet lokale të vitit 2000 Partia Socialiste në rrethin e Librazhdit vendosi që kandidaturat për kryetarë të njësive vendore të ishin produkt i një votimi në Komitetin Drejtues të rrethit. Kjo mënyrë përzgjedhjeje megjithëse rezultoi e suksesshme nuk u përsërit në vitin 2003 ku si rezultat i një vendimi të Kryesisë së partisë në qendër, kandidaturat u përzgjedhën nga vetë ajo. Humbja e Partisë Socialiste në njësitë vendore, kur si rreth konsiderohet si bastion i së majtës tregoi se kandidaturat e përzgjedhura në



qendër nuk ishin më të mirat e mundëshme. (Sigurisht ky nuk ishte faktori i vetëm i humbjes por më i rëndësishmi). Pra është shumë i rëndësishëm decentralizimi i partisë nga qendra në bazë duke iu dhënë më shumë hapësirë në vendimmarrje autorësisë dhe strukturave lokale të partisë në përzgjedhjen e kandidatave, ekipeve apo platformave politike me qëllim që ato të jenë sa më votuara.

Kjo do të sillte një stimulim më të madh të anëtarëve të partisë apo drejtuesve lokalë të cilëve do t'u vlerësohej mendimi i dhënë. Është për t'u theksuar se parimi "Një Anëtar Një Votë" vjen në kohën e duhur për partitë politike shqiptare, zbatimi i këtij parimi do t'i bëjë partitë më demokratike, më të hapura ndaj të gjitha grupeve shoqërore, do të nxisë debatin dhe llogaritjen brenda partisë. Do të afrojë tek vetja edhe ato intelektualë të cilët nuk afrohen për shkak të bunkerizimit të partive, dhe dhënien e shanseve të barabarta për të bërë karrierë, si dhe do të ulte ndjeshëm numrin e skeptikëve ndaj partive politike dhe sistemit në përgjithësi. Partia Socialiste e zbatoi e para këtë parim në krijimin e Komiteteve Zonale Elektorale (KZE) të cilat janë struktura krejt të reja politike që krijohen në bazë zonash elektorale. Jam i bindur se mënyra shumë demokratike e krijimit të tyre do të ketë ndikimin e vet pozitiv në zgjedhjet e ardhshme elektorale.

## **Infrastruktura**

Për një parti politike është shumë i rëndësishëm kontakti i vazhdueshëm që ajo duhet të ketë me anëtarët e saj. Duke i mbajtur ata në korrent të zhvillimeve politike në zonë apo qendër të debatojë me ta për programet politike, apo ekipeve drejtuese, dhe të marrë prej tyre opinione për çdo çështje në diskutim. Rrugët e komunikimit për të arritur këtë qëllim në zonat urbane janë të shumta por në degët lokale të partisë dy janë mundësitë:

- Media
- Kontakti i drejtëpërdrejtë

Media është një mënyrë shumë komode e të bërit politikë, ajo vitet e fundit ka njohur një zhvillim të jashtëzakonshëm. Është evident fakti se çdo ditë dalin mbi 30 tituj gazetash të përditshme, apo periodike si dhe dhjetra media vizive apo audive. Ato sigurisht kanë një ndikim të madh në fushatën elektorale por për

fat të keq ato janë grumbulluar. Kryesisht në qytetet e mëdha dhe pothuajse fare në qytetet e vogla apo fshat, ku jeton mëse gjysma e popullsisë. Kjo ka sjellë një lloj diferencimi në marrjen dhe përcjelljen e informacionit mes fshatit dhe qytetit. Megjithatë degët lokale të paktën në raste fushatash duhet të botojnë gazeta në nivel lokal për të bërë të qartë programin e tyre për anëtarët dhe votuesit. Mënyra tjetër e komunikimit është ajo e kontaktit të drejtëpërdrejtë të liderëve lokalë me bazën e partisë në formë tubimesh, aktiviteteve, seminaresh e trajnimeve të tjera. Kjo është edhe forma më e përhapur e të bërit politikë sot.

Kjo mënyrë politikëbërjeje është shumë e efektshme pasi vizita e një drejtuesi lokal në një organizatë të caktuar është më shumë produktive se sa shpërndarja e fletushkave por ajo kërkon një harxhim më të madh energjish, fondesh dhe burimesh njerëzore. Pra mungesa e fondeve është një ndër problemet më të mëdha në të cilat ballafaqohen degët lokale të partive sot, pasi ato nuk janë bërë të afta të përfitojnë nga donacionet e ndryshme, një pengesë serioze këtu është edhe ligji për financimet e partive politike.

## **Si konkluzion**

Partitë politike sot në Shqipëri janë ende larg të qenit vërtet demokratike në kuptimin organizativ, filozofik, manaxherial etj. Ato duhet patjetër të transformohen më tej, të paktën të arrijnë në nivelin e zhvillimit të vetë shoqërisë shqiptare, si dhe të jenë të afta të marrin rolin që u takon sipas Kushtetutës.

## 4. Roli i medias në zgjedhje

*Melsi Labi*

Në çdo vit elektoral diskutohet në media dhe përgjithësi se cili politikan apo cila forcë politike fitoi. PSE? Të thuash që media nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në vënien në funksionim të demokracisë, është një mendim i pastudiuar dhe njëkohësisht i pabazuar. Kjo pasi në rrjedhën e historisë është provuar qartë roli i saj.

Ishte propaganda një nga armët më të fuqishme që solli dhe mbajti në pushtet për një kohë relativisht të gjatë atë që është quajtur “RAJHU III”. Po ashtu ishte propaganda ajo që udhëhoqi mendjen e popujve drejt një vizioni të qartë për një Europë të bashkuar. Duket qartë se roli i medias është bërë deciziv në politikat demokratike në gjithë botën. Madje tashmë është gati e pamundur të imagjinosh apo të gjesh një vend demokratik sot, në të cilin një kandidat elektoral mund të fitojë shumicën pa përdorur median. Arrihet të mendohet deri aty sa për disa parti apo kandidatë imazhi i tyre para medias është shqetësimi kryesor. Por diskutimi rreth rolit të medias më shpesh duhet të fokusohet rreth asaj që quhet “watchdog role”. Kjo logjikë me të drejtë përdoret nga vendet me demokraci të përparuar si Mbretëria e Bashkuar apo SHBA, duke i veshur medias pushtetin e informimit dhe të diskutimit. Pra media mund të informojë masën e gjerë publike për problemet publike si dhe të nxiti debatin në rast të nevojshëm.

Gjithashtu roli i medias mund të jetë më specifik dhe në një bashkëpunim të plotë me publikun në fushatë elektorale, jo vetëm duke pasqyruar llojin e qeverisjes dhe arritjet e saj, por gjithashtu

dhe në shumë mënyra të tjera, si psh:

- duke edukuar të gjithë votuesit si të ushtrojnë të drejtat e tyre demokratike në mënyrë demokratike;
- duke raportuar drejt dhe paanësisht rreth zhvillimeve të fushatës elektorale;
- duke siguruar platforma të sakta të partive politike për ta përcjellë qartë mesazhin të elektoratit përkatës;
- duke i lejuar partive të ndryshme të debatojnë me njëra-tjetrën;
- duke monitoruar numërimin e votave dhe duke raportuar me paanësi ato.

Si dhe më e rëndësishmja të ruhet heshtja elektorale në kuadrin kohor të përcaktuar me ligj para dhe gjatë procesit të votimit. Idealisht gazetatat, emisionet televizive duhet t'i japin një kohë të barabartë të gjithë kandidatëve dhe asnjëherë të mos i japin përparësi njerit kandidat apo tjetrit. Për mendimin tim në Shqipëri për të qenë të sqartë me veten kjo logjikë nuk ekziston pasi fatkeqësisht nuk ekzistojnë media apo elemente të saj të pavarur nga politika.

Gjithësesi media nuk është i vetmi mjet i informacionit për votuesit, por në një botë të dominuar nga teknologjia ajo që duket është më kuptimplote se sa fjalët. Në këtë kontekst duke ditur se media ka një pushtet të pa krahasueshëm, atë të informacionit, duhet patur kujdes. Për mendimin tim nuk duhen lejuar të kalohen kompetencat e tyre ligjore të përcaktuara më parë pasi ekziston mundësia dhe dëshira për të korruptuar njerëz të medias për qëllime të caktuara elektorale dhe kjo mund të sjelli precedent të rrezikshëm në ngjarjet që pasojnë. Në këtë pikë trinomi: shoqatat joqeveritare, shteti, media duhet të sigurojë paprekshmërinë etiko-profesionale si të vetes dhe të tjetrit. Në anën tjetër kjo logjike i jep të drejtë votuesit:

- të bëjë një zgjedhje pas një informimi të plotë;
- i jep të drejtë kandidatit të shpalosi platformën e tij nëpërmjet medias;
- i jep të drejtën dhe vetë medias të raportojë dhe të shprehë mendimin e saj nga këndvështrimi i saj në shërbim të interesit publik.

Duke u bazuar në këtë logjikë mendimi, në rolin e padiskutueshëm të medias në zgjedhje (si dhe këto të drejta

të cilat garantohen në nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut), unë do të sugjeroja që çdo vit elektoral të mos mendojmë apo pyesim cili politikan apo parti politike fitoi, por cila PLATFORMË fitimprurëse për popullin fitoi, ose me saktë duhet të fitojë sepse çdo veprim i matur dhe i studiuar si dhe çdo përpjekje e përgjithshme për të organizuar dhe përmirësuar jeten sociale si dhe mekanizmat që e plotësojnë atë bëhet për këtë qëllim. Të parandalosh është njëqind herë më mirë se sa të kurosh.

## 5. Transparenca e të ardhurave të partive politike

*Genti Minarolli*

Një nga elementët më të rëndësishëm gjatë fushatës elektorale janë dhe të ardhurat që shpenzojnë partitë politike gjatë kësaj fushate. Në këtë mënyrë, financat e partive politike, janë shndërruar në pikat më të nxehta të fushatës elektorale, e veçanërisht në këtë periudhë prag zgjedhjesh. Shumat e mëdha të parave të shpenzuara gjatë fushatës së partive politike, apo dhe të një kandidati për deputet, janë kthyer në modë për politikën shqiptare.

Është e vërtetë që edhe në vendet perendimore e me një demokraci të zhvilluar shpenzohen shuma të mëdha, por në Shqipëri, ndrysha nga këto vende, këto shuma nuk deklarohen, çka të shtynjë të mendosh se para jo të pastra qarkullojnë në ambjentet politike. Në këto kushte, transparenca e të ardhurave të partive politike, por dhe të kandidatëve për deputet, është një domosdoshmëri për të patur një klasë politike të pastër dhe të paprekshme nga elementi kriminal.

Problemet e mëdha që po kalon vendi ynë me nivelin e lartë të korrupsionit dhe të trafikëve ilegale mund të gjejnë zgjidhje, vetëm nëpërmjet një transparence të gjerë të fondeve dhe kapitaleve që partitë politike menaxhojnë gjatë fushatave elektorale. Partitë politike duke qenë transparente me publikun do të jenë të imunizuara ndaj infiltrimit të elementit kriminal në rradhët e tyre. Shqipëria e paskomunizmit është shndërruar në një vend ku disnivelele ekonomik është mjaft i madh. Një grup i vogël njerëzish po mbledhin rreth tyre shuma të mëdha parash, ndërkohë që

pjesa më e madhe e popullsisë ndodhet në varfëri, madje një përqindje e lartë jetojnë në nivelet e varfërisë së skajshme. Në një kohë kur paga mesatare e një shqiptari është jo më shumë se 100 dollarë amerikanë, shpenzimi i shumave të mëdha gjatë fushatës së zgjedhjeve nga elementët kriminal, të cilët posedojnë para me bollëk, do të rrezikonte Shqipërinë dhe shqiptarët të mos integrohej në Bashkimin Europian, sikurse dhe do ta shndërronte në një mbretëri të mafias dhe organizatave kriminale. Duke u ndodhur në këtë udhëkryq, midis të mirës dhe të keqes, do të ishte e domosdoshme që financat e partive politike, të jenë transparente.

Kur them transparente, nënkuptoj deklarimin e të gjitha donacioneve dhe shumave të parave që u jepen partive politike nga individë apo biznese të caktuar, pra të jetë transparente pjesa e buxhetit të partive që mbushet nga donacionet, e jo pjesa që i jep buxheti i shtetit këtyre partive, pasi kjo kontrollohet nga Kontrolli i Latë i Shtetit. Në këtë mënyrë Shqipëria do të lërë pas tranzicionin e gjatë dhe politika shqiptare do të shkëputet një herë e mirë nga elementët kriminalë dhe mafiozë. E gjitha kjo do të pasqyrohet në ngritjen e nivelit ekonomik të vendit si dhe në përmirësimin e jetesës së qytetarëve shqiptarë, të cilët e meritojnë të jenë në krah të popujve të tjerë europianë.

## 6. Pjesëmarrja e qytetarëve dhe roli i tyre në procesin zgjedhor

*Mariela Hoxha*

Që kur se në Athinën antike lindi demokracia, roli i qytetarit erdhi e u forcua gjithmonë e më shumë, duke i dhënë këtij të fundit forcën e pushtetit të vërtetë publik. Përfaqësuesit do të dilnin “nga ta dhe për ta”, ndaj edhe qytetari nuk mund të rrinte jashtë skemës demokratike të zgjedhjes. Në atë kohë, qytetarët ishin pjesë e rëndësishme e proceseve zgjedhore dhe pse vetëm një pjesë e vogël e tyre e gëzonin këtë të drejtë. Në praktikë, pjesëmarrja e gjerë e popullit ishte shumë e vështirë dhe e përcaktuar rreptësisht me ligj, ndaj edhe në këto procese mernte pjesë vetëm një pakicë qytetarësh. Në shekuj zhvillimi i procesit zgjedhor do të shoqërohet gjithashtu me evoluim edhe në mënyrën e pjesëmarrjes së qytetarit në votim.

Shekulli i XIX-të i hapi rrugën, drejt të drejtës për të zgjedhur dhe t’u zgjedhur, edhe kategorive të përjashtuara nga ky proces. Të fundit që e fituan atë ishin gratë (në vitin 1926). Shtrirja e procesit zgjedhor solli edhe përparimin e teknikave për bindjen e votuesit, duke u fokusuar tashmë në profilet e shumëllojshme që paraqiste elementi “votues”.

Përsosja e sistemeve zgjedhore bëri që gara elektorale të bëhet më e fortë dhe gati-gati e pamëshirshme. Qytetarët janë shënjestra dhe sigurisht forca kryesore në ndërtimin e një procesi të rregullt e të ndershëm. Çdo parti politike e mbështet fitoren e saj në forcën e një qytetari i cili beson në alternativën e saj. Çdo platformë elektorale, çdo alternativë e krijuar dhe çdo tentativë e mundshme bindjeje, i drejtohen një *target group* – i shënjestruar



sigurisht përmes rradhëve të qytetarëve. Nga ana e tyre, këta të fundit, mbajnë në duart e tyre të gjithë mbarëvajtjen e procesit, e nga kjo, në çdo sistem realisht demokratik, mirëqënien e pushtetit dhe qeverisjes në fuqi. Përmes një regjistri të saktë zgjedhësish, institucionet përkatëse kanë mundësi të nxjerrin lista sa më të sakta rreth numrit të votuesve pjesëmarrës në proces. Ndërkohë që verifikimi në kohë i emrit në listë, interpretohet pa dyshim si interesim i qytetarit për votimin dhe pjesëmarrjen e tij në të.

Vitet e fundit të tranzicionit në Shqipëri kanë lënë gjurmët e tyre sigurisht edhe në përgjegjësinë morale që votuesi duhet të ketë në pjesëmarrjen e tij në këtë proces të rëndësishëm për politikën e vendit. Indiferenca e qytetarëve ishte dhe vazhdon të mbetet një ndër ato faktorë të cilët e lënë politikën e vendit tonë, jashtë parametrave standartë të një sistemi politik të suksesshëm. Duke mos marrë mbi vete përgjegjësinë e së ardhmes politike të shtetit, qytetari heq dorë vullnetarisht nga shtrimi i rrugës për një të ardhme më të mirë. Nëse nuk jep diçka sot, mos kërko asgjë nesër.

Indiferencën e qytetarëve, në 15 vite tranzicion, e kanë ushqyer sigurisht edhe faktorë të tjerë si, keqmenaxhimi i pushtetit, moskrijimi i politikave efikase, zhgënjimi i përsëritur nga “ të zgjedhurit” etj. Dhe kohët e fundit u desh të shtohesh edhe problemi i listave të pasakta, që të binte edhe më shumë numri i atyre që në ditën e zgjedhjeve, i drejtohen kutisë së votimit. Numri i shqiptarëve që flasin për politikë është i jashtëzakonshëm, ndërkohë që për të votuar, të gjithë stepen. E pra, përpara 15 vjetësh, e kërkuam me ngulm e dëshirë të madhe, këtë sistem pluripartiak ku të mund të vendosësh për alternativën që të duket më bindëse.

Në botë funksionojnë prej kohësh fushatat e edukimit qytetar rreth procesit të votimit dhe ndërgjegjësimit publik për pjesëmarrje në votim. Në SH.B.A, pikërisht në sajë të këtyre fushatave ndërgjegjësimi, në zgjedhjet e fundit, u rrit dukshëm numri i qytetarëve amerikanë, të cilët më 1 tetor, ditën e zgjedhjeve, iu drejtuan kutisë së votimit. Kjo ishte një arritje e madhe, sigurisht ndër sukseset e tjera të asaj fushate.

Të mos harrojmë edhe një kategori tjetër qytetarësh, të cilët edhe pse nuk banojnë brenda kufijve shtetërorë, gëzojnë njësoj të drejtën për të zgjedhur, si votues me të drejta të barabarta me të

gjithë votuesit e tjerë. Përmes nxjerrjes së akteve nënligjore, një shtet i jep të drejtën edhe këtyre shtetasve, të japin mendimin e tyre për sistemin qeverisës të vendit. Ata nuk duhen lënë kurrsesi jashtë këtij procesi, i cili ka për qëllim të pasqyrojë dëshirën e çdo qytetari, me banim jashtë ose brenda vendit. Sigurisht që kjo kërkon një impenjim të veçantë nga ana e qeverisë dhe institucioneve të përfshira, por kjo siguron zbatimin më të drejtë të demokracisë në zgjedhje. Vota e emigrantëve ka vlerë po aq të madhe sa edhe ajo e shtetasve të tjerë.

Shqipëria tashmë e ka nisur rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian dhe dëshira për të qenë pjesë e tij është e kahershme. Por për të qenë edhe ne, pjesë e kësaj familjeje të madhe me rregulla dhe detyra, duhet që të arrijmë sigurisht ato standarde aq të përfolura të cilat do të na bëjnë të jemi gati për përballjen tonë finale me botën perëndimore. Të gjithë e dimë se kushti më i afërt dhe më i rëndësishëm për t'u plotësuar është pikërisht, zhvillimi i një procesi zgjedhor të lirë e të ndershëm.

Përveç qeverisë, një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e tij, do të luajnë edhe qytetarët, të cilët me maturi dhe përgjegjësi duhet ta përballojnë atë. Pa iu rikthyer gabimeve të së shkuarës, zgjedhësit shqiptarë duhet të bëjnë zgjedhjen e tyre të lirë e të sigurtë për faktin se tashmë kanë në duar të ardhmen e tyre. Që me krijimin e komunitetit evropian, politika e vendeve anëtare, i hodhi sytë nga qytetari, si përfutuesin dhe pësuesin kryesor të politikave që do të ndërmerreshin. Qytetaria evropiane u bë një ndër më të fuqishmet në çdo sistem udhëheqës. Tashmë, në duart e saj u përqendruan shumë vendime të rëndësishme.

Me anë të forumeve të hapura, qytetarët u bënë pjesë e qeverisjes. Pikërisht, për sa i përket pushtetit përzgjedhës të qytetarëve në Evropë, viti 1979, shënoi një kthesë të madhe. Përpara vitit 1979, përfaqësuesit për në Parlamentin Evropian (që në atë kohë quhej Asamble) përzgjidheshin nga parlamentet kombëtare të vendeve anëtare, ndërsa pas këtij viti, u vendos që eurodeputetët të zgjidheshin nga vetë qytetarët e secilit shtet. Atyre pra iu besua kjo detyrë e rëndësishme pikërisht për tu dhënë një mundësi përfaqësimi sa më demokratike e të ndershme. Ky shembull tregon se sa i rëndësishëm është edhe se sa i rëndësishëm po ashtu vlerësohet qytetari në procesin zgjedhor. Prania dhe impenjimi i tyre shpreh gatishmërinë e tyre për të qenë

të përfshirë në jetën politike dhe vendimmarrëse të vendit.

Ashtu si edhe në të gjitha kushtetutat e vendeve të tjera, edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 45, pika1, përcaktohet mundësia për të zgjedhur e për t'u zgjedhur e çdo shtetasi shqiptar i cili ka mbushur apo mbush në ditën e zgjedhjeve moshën madhore (18 vjeç). Kështu shteti i jep qytetarit të tij këtë të drejtë duke pritur sigurisht që ai ta shfrytëzojë atë. Me dëshirën e mirë, për t'i ofruar diçka vendit të tij qytetari bën zgjedhjen e tij dhe distancohet nga indiferenca e dëmshme.

## **7. Zgjedhje të lira dhe të ndershme**

*Korab Ndreu*

Maturimi i një politike të një vendi duket kur kjo politikë është e aftë të prodhojë zgjedhje të lira dhe të ndershme. Për një rezultat të pranuar nga i gjithë spektri politik rëndësi ka hartimi i infrastrukturës zgjedhore.

Në fund të fundit synimi kryesor i forcave politike është sesa ata mund t'i afrohen problematikës së qytetarëve nëpërmjet platformave që parashtrojnë. Sigurisht që përgjegjësia kryesore për mbarëvajtjen e një procesi zgjedhor e mban forca politike qeverisëse.

Politika është një fenomen që mban në jetë institucionet, ndërsa politikanët janë llogaridhënësit përpara elektoratit. Jo pa qëllim e përmenda këtë si definicion për të ditur se sa kulturë politike ka një kandidat për të funksionuar në jetën politike të vendit.

Një proces zgjedhor transparent nuk mund të zhvillohet pa praninë e një media transparente. Një media e pavarur shërben si urë lidhëse ndërmjet institucionit dhe qytetarit. Gjatë procesit zgjedhor rëndësi ka që media të ketë paanshmëri.

Në të kundërt duke nxjerrë shifra të parakohshme luan rol tundues për elektoratin, nëqoftëse sistemi zgjedhor bëhet me më shumë se një raund.

### **Cili është koncepti themelor i një sistemi zgjedhor?**

Forca politike të ndryshme vënë përballë njëra-tjetrës,

programe, platforma të cilat parashtrohen në elektorat, rezultati i të cilave ndikon në stabilitetin ekonomik të vendit. Shkurtimisht është një garë për poste por edhe për përgjegjësi ndaj elektoratit.

Në organizimin e zgjedhjeve unë mendoj se nuk duhet harruar fenomenin e gjithëpërfshirjes, brenda një kahu politik të forcave të vogla politike të cilat kanë një rol dytësor por të pamohueshëm.

Në një proces zgjedhor faktor i rëndësishëm janë edhe burimet financiare që mbështesin fushatën. Transparenca e fondeve të ligjshme dhe jo të ligjshme, abuzimet me fondet të kandidatëve për deputetë, të cilët mbajnë poste qeveritare për të siguruar performancën politike. Që një sistem zgjedhor të funksionojë në parametrat e duhur kërkohet një angazhim total i spektrit politik. Moment kyç për vendin tonë është ende hartimi i listave zgjedhore ku duhet bërë regjistrimi i saktë i votuesve.

Përse organizohen zgjedhjet? Mendoj se shtylla mbi të cilën funksionon një demokraci e një vendi është rotacioni i pushtetit. Fushata zgjedhore e një force politike të caktuar bëhet më efçente kur ajo ka të hartuara plane afatshkurtër, afatmesëm, që janë të mundshme për t'u realizuar n.q.s. fiton zgjedhjet. Pra mundësia i jepet asaj force që ndjehet më afër nevojave të individit. Bërja e qartë përpara elektoratit e menaxhimit të sektorëve të ndryshëm mbi të cilët dora e pushtetit është e pamohueshme, motivon më tepër elektoratin për të votuar atë forcë politike.

## 8. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin zgjedhor

*Ermelinda Muho*

Sot në botën demokratike, që bazohet në votën e lirë dhe në vullnetin e popujve, zgjedhjet janë i vetmi mjet legjitim për të qeverisur. Sot njihen dy sisteme të ndryshme zgjedhore, sistemi mazhoritar dhe ai proporcional. Ndërsa në praktikë, në shumicën e rasteve gjejmë forma të përziera, sikurse u propozua edhe tek ne për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Struktura politike e një vendi dhe procesi i formimit të vullnetit politik mund të ndikohen në mënyrë vendimtare nëpërmjet përpunimit të sistemit zgjedhor, sepse sikurse rendi brendapartiak, edhe raporti mes partive dhe marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe parlamentit varen nga sistemi zgjedhor. Nga ana tjetër, traditat e caktuara politike, gjendjet historike dhe kushtet shoqërore lejojnë vetëm sisteme të caktuara zgejdhore. Aplikimi universal i çdo sistemi nuk është i mundshëm. Manipulimi i sistemit zgjedhor pa marrë parasysh strukturat konkrete të dhëna politike dhe sociale rrezikon humbjen e funksionit të vërtetë të zgjedhjeve, nëse sistemi zgjedhor nuk pranohet si i ligjshëm nga pakica.

### **Sistemi proporcional: përparësitë dhe të metat**

Se sa i ndikueshëm është stili politik dhe struktura politike e një shoqërie nga përpunimi i sistemit zgjedhor, këtë e tregon përmbledhja e dallimeve kryesore. Sistemi proporcional bazohet në parimin, sipas të cilit vendet në parlament ndahen saktësisht në

proporcion të drejtë me votat që iu janë dhënë partive në të gjitha qendrat zgjedhore. Nëse një parti përkatëse fiton 10 % të votave, asaj i jepen 10 % të mandateve. Në këtë mënyrë, parlamenti shndërrohet në një lloj pasqyre politike të rrymave të ndryshme të zgjedhësve. Çdo pakicë dhe çdo drejtim politik-pragmatik është i përfaqësuar dhe mund të paraqesë në parlament pikëpamjet e veta. Sistemi proporcional i zgjedhjeve bën të mundur edhe themelimin e lehtë dhe me sukses të partive të reja, sepse për përfaqësimin e tyre në parlament mjafton të fitojnë vetëm nga një votë në çdo zonë elektorale, sepse ato mbledhen në fund së bashku, kështu që fitimi p.sh. i 1 % të votave nga një parti e re, i jep asaj mundësinë të fitojë disa vende në parlament.

Joshja për themelimin e partive të reja padyshim që sjell me vete elemente të reja, nxit degëzimin e partive dhe grupeve të interesave të kufizuara. Për këtë arsye, sistemit proporcional të zgjedhjeve i përgjigjet shpesh parlamenti i ndarë në shumë grupe parlamentare, nga të cilat dalin qeveri të paqëndrueshme koalicioni me dobësi të njohura të udhëheqjes dhe me kriza.

Votuesi me votën e tij mund të ndikojë në formimin e qeverisë, sepse partitë në raste të zakonshme nuk përcaktohen në fushatat elektorale për koalicione të caktuara. Meqë sukseset e qeverisë çdo anëtar i koalicionit i konsideron të vetat, ndërsa mossukseset ua dedikon partnerëve, votuesi e ka edhe më të vështirë të njohë kompetentët, si në aspektin pozitiv ashtu edhe në atë negativ. Kandidatët për deputet, në sistemin proporcional përcaktohen në kongreset vendore apo të qarqeve, e jo nga komisionet partiake lokale, gjë që iu jep mundësi të madhe ndikimi i kryesive të partive. Votuesi nuk zgjedh kandidatin përkatës, por duhet t'ia japë votën listës së partive përkatëse, në të cilën kandidatët janë të renditur sipas një rradhe të caktuar. Edhe pse votuesi nuk ka një përfaqësues të një zone të caktuar elektorale, ai u jep mundësi partive që gjatë përpilimit të listave të kenë në konsideratë të gjitha grupet e rëndësishme të partisë dhe shtresat e synuara të votuesve. Nga ana tjetër, kjo u jep mundësi shoqatave të interesave të premtojnë përkrahje ndaj partisë, nëse ato sjellin anëtarët e këtyre të fundit në listën e kandidatëve.

## **Sistemi mazhoritar: përparësitë dhe të metat**

Në dallim nga sistemi proporcional, në sistemin mazhoritar, zona elektorale ndahet në po aq qendra zgjedhore, sa është numri i ofruar i vendeve në parlament. I zgjedhur konsiderohet ai që në zonat elektorale ka fituar ose shumicën absolute ose shumicën relative të votive. Këtë, në kushte normale, e arrijnë vetëm kandidatët që mbështeten nga partitë e mëdha apo partitë e bashkuara rajonale. Nga ana tjetër, ato duhet të heqin dorë nga përfaqësimi vetëm i interesave të veçanta dhe duhet të bëhen tërheqëse për shumë grupe të mëdha të popullsisë, me qëllim që të arrijnë shumicën e votave. Sistemi mazhoritar i zgjedhjeve i detyron në këtë mënyrë partitë të modernizohen dhe të heqin dorë në programet dhe veprimet e tyre nga përfaqësimi i grupeve ekstreme.

Në perspektivën historike, zgjedhja e mazhorancës dhe sistemet dy partiake janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Edhe pse sistemi mazhoritar nuk mund t'i prodhojë sistemet dy partiake, ai i ruan dhe i siguron ato. Në kushte të tilla, votuesi në zgjedhje vendos mes dy programeve dhe grupeve të ndryshme qeveritare. Grupi fitues qeveritar mund të shpresojë në këtë mënyrë në një shumicë të qëndrueshme parlamentare të partisë së tij. Nga ana tjetër, një gjë e tillë e ndihmon votuesin që në zgjedhjet e ardhshme të kërkojë përgjegjësitë e qeverisë, sepse në rrethana të qarta mazhoritare suksesi apo mospuksesi politik mund të identifikohet qartë. Për mospukseset eventuale nuk mund të fajësohen partnerët e koalicionit. Ndikimi i votuesve në formimin e qeverisë dhe mbi efektin e qeverisë së mbështetur te shumica përbëjnë përparësitë e sistemit dy partiak të stabilizuar nga sistemi mazhoritar i zgjedhjeve. Përveç kësaj, sistemi mazhoritar krijon ingranim relativisht të ngushtë mes parlamentit dhe zonës elektorale, përcakton deri në një farë mase deputetët në zona të caktuara dhe pengon në këtë mënyrë krijimin e distancave të mëdha mes elektoratit dhe të zgjedhurve. Njëkohësisht, organizimi i ulët lokal, gjatë përcaktimit të kandidatëve fiton rëndësi të madhe, gjë që është e dëshirueshme në procesin



e demokratizimit të brendshëm të partive. Megjithatë nuk duhen anashkaluar të metat e sistemit mazhoritar. Përcaktimi i kandidatëve vetëm nga këndvështrimi i interesave lokale bën shpesh që pakicat përkatëse apo grupet e ndryshme të popullsisë të mos përfaqësohen. Shembull në këtë aspekt janë ndër të tjera femrat, të cilat, duke patur parasysh rrethanat ekzistuese, sot e kanë më të lehtë të arrijnë në parlament se sa të fitojnë votat e një zone përkatëse elektorale.

Përveç kësaj, ngaqë në zonat elektorale merren në konsideratë vetëm votat që i janë dhënë kandidatit të suksesshëm, grupet e tjera të zgjedhësve mbeten të papërfaqësuara në parlament. Sistemi mazhoritar i zgjedhjeve i jep shpesh mundësinë një shumice përkatëse të ngushtë të ketë një përfaqësim tepër të lartë në parlament. Në Angli ka ndodhur që Partia Konservatore të fitojë me 38.2% të votave mbi 56% të vendeve në parlament. Shkaku për këtë qëndron pjesërisht në ndarjen e zonave elektorale, të cilat është e pamundur të mbahen njëlloj të mëdha dhe të strukturohen në atë mënyrë që të mos dëmtohet apo përfitojë asnjë parti. Një "gjeometri" e tillë e zonave elektorale zgjedhore hap një mundësi tjetër të manipulimeve. Përveç kësaj, ky sistem zgjedhor pengon realizimin e përfaqësimit parlamentar të pakicave, në rast se ato nuk janë në shumicë të paktën në disa zona elektorale. Lindja e partive të reja është praktikisht e pamundur. Përveç kësaj, edhe stabiliteti i qeverisë me shumicë absolute vihet në pikëpyetje, në rast se beteja e partive përfundon me fitore të ngushtë.

Për këtë arsye, suksesi i sistemit mazhoritar të zgjedhjeve parashikon që të dy partitë të jenë të hapura nga të gjitha anët dhe të mos qëndrojnë në opozitë parimore ndaj njëra – tjetrës. Në të kundërt, ndryshimet mes partive do të nënkuptonin përmbysjen totale të bashkësisë. Përveç kësaj, sistemi dypartiak i stabilizuar përmes sistemit mazhoritar të zgjedhjeve kërkon një konsensus të fortë në popullsi. Duhet të ekzistojë ndjenja e të qenit në të njëjtën anë, toleranca dhe gatishmëria për të mos e konsideruar përfaqësuesin e palës së kundërt si armik. Në një popull të përçarë në aspektin social dhe në çështjet kryesore të bashkëjetesës politike, sistemi mazhoritar do të kishte jo rrallë efekte negative, sepse ndërrimi i pushtetit nuk do të ishte i mundur për shkak të ngurtësisë së fronteve dhe pakicat e mëdha nuk do të përfaqësoheshin në parlament. Jo matura por radikalizimi

dhe polarizimi do të ishte rezultati i kësaj. Në disa raste të tilla do të paraqitet nevoja e modifikimit të sistemit proporcional të zgjedhjeve.

Sot është vështirë të thuhet parimisht se cili sistem zgjedhor është më demokratik. Në varësi të traditës historike, sistemit ekzistues partiak dhe rrethanave sociale në një shoqëri duhen zgjedhur një sistem apo një tjetër. As për këtë element konstruktiv të demokracisë nuk ekziston një recetë e përgjithshme, por forma të ndryshme, në të cilat mund të realizohet demokracia. Përshtatshmëria varet nga shkalla e realizimit të pjesëmarrjes politike të qytetarëve dhe aftësia e qeverisjes së personave të zgjedhur.

## **Sistemi zgjedhor në Shqipëri**

Sistemi zgjedhor në Shqipëri thuhet se është sistem me tendencë të theksuara mazhoritare. Arsyeja themelore është sepse të gjithë mendojnë se politikën në këtë vend e bëjnë politikanë “të fortë” autoritaristë. Sistemi mazhoritar është sistem që funksionon dhe ka sukses për parti që kanë me shumicë personalitete të forta dhe me autoritet, për të tjerët ai është gjyle në këmbë. Për këtë arsye, të tjerët e kanë gjetur arsyen e mosarsyes së tyre në trajtimin e sistemit tonë elektoral si sistem mazhoritar, ose në thelb mazhoritar. Në fakt, me përjashtim të zgjedhjeve të vitit 1996, kur sistemi ynë elektoral ka pasur tipare mazhoritare të ngjashme me ato që shfaq sot sistemi italian i zgjedhjeve, në të gjitha rastet e tjera sistemi elektoral ka patur tipare shumë të theksuara proporcionale. Formalisht sistemi ynë elektoral hyn në kategorinë e sistemeve të përziera elektorale, ku zgjedhjes së drejtpërdrejtë të kandidatëve nga zona njëemërore, i bashkangjitet zgjedhja e një numri prej tyre nga lista shumë-emërore të partive politike sipas një formule kushtetuese e cila siguron kompesim të lartë proporcional të përbërjes së parlamentit. Parlamenti ka 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen nga po aq zona njëemërore, kurse 40 nga listat shumëemërore të partive në bazë të rezultatit nacional të arritur prej tyre. Matematikisht formula e kompensimit është e aftë që në kushte normale aplikimi të sigurojë kompensim të plotë proporcional. Secila parti parlamentare merr në Kuvend aq vende sa i takojnë sipas ligjit.

Avantazhi thelbësor i sistemit proporcional është se forcën e personaliteteve të forta e zëvendëson me forcën e partive politike. Kjo ecën mirë për sa kohë që partitë nuk bëhen aq të forta sa të na zënë frymën. Format që përfliken më së shumti janë dy: sistem proporcional rajonal dhe sistem proporcional kombëtar. I pari ka të gjitha avantazhet e sistemit proporcional dhe rrit pragun e futjes në parlament (gjë që i pëlqen partive të mëdha). I dyti ka të gjitha avantazhet e sistemit proporcional dhe mund të ruajë pragun e ulët që kemi sot (gjë që u vjen për shtat partive të vogla).

Përveç zgjedhjeve të 22 marsit të vitit 1992, ku është respektuar vota dhe rezultati është pranuar nga të gjitha palët, zgjedhjet e tjera janë kontestuar, si nga faktorët politikë shqiptarë, ashtu edhe nga ato ndërkombëtarë.

Moszhvillimi i zgjedhjeve të lira lidhet me shumë arsye, por më kryesorja ka qenë dhe është mungesa e vullnetit politik të partive në pushtet për të zhvilluar zgjedhje të lira e të ndershme pasi këto të dyja kanë qenë në pushtet gjatë këtyre 14 vjetëve.

## 9. Pregatitja për fushatën elektorale

*Albana Imami*

Në shumë mënyra, grupi i punës për fushatën elektorale i ngjan organizatës së partisë lokale. Ndryshimi themelor qëndron në atë që organizata e partisë lokale është një funksion i vazhdueshëm që ekziston nga një zgjedhje tek tjetra, ndërsa ky grup është i përkohshëm dhe shpërndahet pas ditës së zgjedhjeve. Fushatat janë kaotike. Prandaj, në një fushatë kërkohen përpjekje të organizuara dhe të disiplinuar brenda një kohe të shkurtër. Gjatë fushatës duhet të rekrutohet kandidati, të përpilohet plani i fushatës, të organizohen vullnetarët, të komunikohet mesazhi dhe të binden shumica e votuesve për të zgjedhur kandidatin në ditën e zgjedhjeve. Shumë shpesh kandidatët dhe grupi i punës së fushatës e ngatërrojnë veprimin me progresin. Një fushatë që vetëm reagon ndaj ngjarjeve të ndryshme është fushatë që nuk ecën përpara. Plani e ndihmon grupin e punës së fushatës të bëjë më shumë se sa thjeshtë të reagojë ndaj ngjarjeve të ndryshme. Një plan fushate shërben si një “hartë rrugore” për grupin e punës së fushatës. Ky grup mbështetet tek kjo hartë për të parë se ku po shkon, ç’rrugë duhet ndjekur për të arritur dhe si të arrijë destinacionin final në ditën e zgjedhjeve.

Kryesore në fushatë është edhe mbledhja e fondeve. Paratë janë një pjesë e rëndësishme e proceseve politike, ngritja e fondeve për partinë nuk duhet të shmanget. Përderisa do të ketë fushatë për zyrën publike, paratë duhet të dalin.

## **Shkrimi i planit të financës**

Kjo gjë në rradhë të parë kërkon hartimin e një plani politik dhe të një buxheti, kur këto janë në vendin e duhur përpilohet një plan financiar i cili përcakton metodat që do të përdoren për t'u rritur fondet dhe për të plotësuar buxhetin. Një program financiar është i rëndësishëm. Ai siguron strukturën dhe organizimin, përcakton një kuadër kohe për ngritjen e fondeve, përcakton përgjegjësitë për individët dhe komitetet, siguron kredibilitet për individë të ndryshëm.

Një çështje tepër e rëndësishme është organizimi i stafit të fushatës elektorale.

Struktura organizative e fushatës duhet t'i përshtatet karakterit të kandidatit dhe nevojave strategjike të vetë veçorive të fushatës. Hapi i parë në strukturën organizative është paraqitja e një master plani. Qëllimet dhe objektivat e hartuara në këtë plan do të diktojnë për llojin e strukturës organizative që do nevojitet për të punuar planin.

Një organizatë krijohet nga nevoja për të treguar autoritet dhe përgjegjësi. Në shumicën e rasteve në legjislaturën shtetërore ose lokale, fushatat fillojnë me një kandidat dhe përfundojnë me një grup. Menjëherë sa hartohet dhe firmoset plani lind struktura e lirë e fushatës.

Fushatat legjislative shtetërore dhe lokale bazohen shumë në punën që vullnetarët bëjnë për stafin e fushatës elektorale, këta njerëz siç është thënë më lart, mbajnë çelësin e pozicionit të fushatës dhe nuk paguhen. I vetmi shpërblim për ta është kënaqësia që ata kanë bërë diçka për zonën, kandidatin dhe kauzën.

## **Metodat e punës**

Metodat e punës janë procedura që ndërmerren nga fushata për të drejtuar burimet bazë dhe për të vënë në jetë strategjinë e vet. Katër llojet bazë të metodave të punës gjatë fushatës përfshijnë: orarin, financat, strukturat e fushatës dhe komunikimit.

**Orari:** Metodat e punës për përcaktimin e orarit, që shpesh mund të rishikohet në të ardhmen, bëjnë që koha e kandidatit

të shfrytëzohet në maksimumin e mundshëm. Orari i fushatës cakton aktivitetet që do bëjnë të njohur kandidatin. Orari duhet të përdoret për të stabilizuar një plan të përgjithshëm nga fillimi i fushatës deri në ditën e zgjedhjeve, me vëmendje të veçantë kushtuar kohës së ngjarjeve të rëndësishme dhe pushimeve. Displinë e madhe duhet të ushtrohet për ta ruajtur orarin e kandidatit nga mbingarkesa me aktivitete që nuk e kanë peshë të madhe në strategjinë e përgjithshme.

**Financat:** Metodot e punës me financat bëjnë të mundur manaxhimin e burimeve monetare me efikasitetin e duhur.

**Struktura e fushatës:** Metodot e punës përfshijnë llojet e strukturave organizative të vendosura për një fushatë që bëjnë të mundur drejtimin e efektiv të burimit të saj më të rëndësishëm – njerëzve. Një strukturë organizative krijon një ndarje të punës duke përcaktuar detyrat që duhet të kryhen, përgjegjësitë dhe autoritetin e secilës punë duke krijuar një “zinxhir urdhëresash” dhe duke krijuar kanale të brendshme komunikimi që do e ndihmojnë fushatën të funksionojë sa më mirë.

**Komunikimi:** Metodot e punës për komunikimin vënë në përdorim talentin dhe krijimtarinë e stafit të fushatës të cilat përcaktojnë metodat e ndryshme të komunikimit politik që do zbatohen. Metodot e ndryshme të komunikimit mund të përdoren për të shpallur një mesazh të fushatës dhe për të siguruar mbështetje mes votuesve me një potencial të konsiderueshëm.

Pak imagjinatë, aftësi organizative dhe puna me grupe mund të krijojnë aktivitete të tilla me shumë përfitime politike. Ja disa nga aktivitetet që mund të zhvillohen gjatë fushatës:

## **Tubimet politike**

Është aktiviteti më tradicional politik. Tubimet janë më shumë të nevojshme në javët e fundit të periudhës së fushtës kur një turmë e madhe dhe entuziaste mund të jetë një faktor i rëndësishëm për të përcaktuar mbarëvajtjen e punës së fushatës disa ditë para

zgjedhjeve.

## **Forumet lokale**

Takimet me organizatat civile mund t'i japin mundësi të mëdha kandidatit për t'iu adresuar një grupi të madh njerëzish dhe pa shpenzuar shumë para meqenëse kandidati e merr fjalën në takimin e një organizate tjetër. Takime të tilla mund t'i japin mundësi kandidatit të shprehë pikëpamjet e tij mbi çështje të rëndësishme që i interesojnë grupeve të caktuara.

## **Fushata elektorale në rrugë**

Është një term që nënkupton rastet kur kandidati duhet të shkojë aty ku ka njerëz, të diskutojë për problemet e tyre, t'i sugjerojë zgjidhje dhe t'i kërkojë votën e tyre. Në këto vende përfshihen zona me dyqane, fabrikat, qyteza universitare, tregje (pazare), festat popullore dhe aktivitetet sportive. Kandidati shpjegon zgjedhjet e tij për problemet atëherë kur problemi ose çështja e krijuar është nxehur aq shumë sa që ka shkaktuar shqetësime personale tek njerëzit.

## **Aktivitetet e ditës së votimit**

Dita e votimit është kulmi i të gjitha përpjekjeve të kandidatit dhe të organizatës së fushatës. Duhet kujtuar se zgjedhjet kanë përfunduar vetëm atëherë kur mbyllen votimet, jo kur hapen ato. Në një votim të mbyllur, aktivitetet që janë përgatitur për ditën e zgjedhjeve mund të vendosin se kush do të fitojë dhe kush do të humbë. Fitorja në zgjedhje kërkon një punë të disiplinuar brenda një kohe të shkurtër për të organizuar njerëzit, për të nxjerrë fondet e duhura, për të komunikuar mesazhin dhe për të bindur shumicën e votuesve për të hedhur votën për kandidatin e duhur. Plani i fushatës vendos objektivat dhe përcakton mjetet që mund ti përdorë kandidati gjatë rrugës së tij drejt fitores. Një fushatë e planifikuar mirë nuk mund ta garantojë fitoren, por një plan i varfër dhe i aplikuar keq shpesh mund të sjellë humbjen e zgjedhjeve.

# 10. Fushatat zgjedhore zbulojnë skarcitetet e medias

*Jorida Nonaj*

Askush më mirë se sa një redaksi gazete nuk e di se çfarë ndodh në një fushatë zgjedhore. Madje, edhe stafet elektorale të kandidatëve në zgjedhje, lokale a të përgjithshme, nuk arrijnë të kuptojnë ashtu siç duhet intensitetin e punës së reporterëve që u duhet të mbulojnë çdo aktivitet partiak. Ndërsa publikut, ai që jep vlerësimin çdo mëngjes, nuk i intereson aspak se si funksionon një sistem i tërë, ai mediatik; mjafton që të kenë në dorë informacionin që i duhet.

## **Analizat joprofesionale**

Prej kohësh, realiteti shqiptar u lejon shumë “analistëve” që të gjykojnë mbi rolin e medias në fushatë zgjedhore; të gjithë, specialistë ose jo, dalin në përfundimin se roli i reporterëve në periudhën parazgjedhore nuk është edhe aq i madh. Ka lodhje fizike, por jo aq shumë intelektuale. E, në fakt, ky opinion nuk është fare i pabazë. Në muajt e fushatës, gazetarët në Shqipëri shndërrohen thjeshtë në “radhitës” të fjalimeve të liderëve partiakë apo të kandidatëve për deputet a kryetar bashkie. Profesionalizmi gazetaresk gjatë fushatave është i papërfillshëm; mjafton të shkruash ato që thotë X politikan që i ka raportet e mira me botuesin dhe puna e gazetarit përfundon aty. Analiza e faktorëve dhe efekteve që japin premtimet apo deklaratat parazgjedhore thuajse është një gjini publicistike, e cila nuk realizohet asnjëherë



brenda parametrave profesionale. E, duke u ndalur në këtë gjini, vlen të theksohet se ka dy lloje analizash: E para, analiza pro një force politike, të cilat publikohen në mediat pranë kësaj partie. E dyta, analiza kundër një force politike, të cilat publikohen me qëllimin për të goditur partinë kundërshtare. Pra, në asnjë prej të dy rasteve, publiku nuk arrin të kuptojë se çfarë ndodh në të vërtetë, duke shkaktuar fenomenin tashmë të njohur shqiptar, “çoroditje të elektoratit”.

## **Skarcitetet**

Asnjëherë në fushatat zgjedhore publiku shqiptar nuk i ka marrë ato që duhet të dijë. Nga media, opinionit i është përcjellë vetëm ajo që duan politikanët që kontrollojnë mediat apo, në rastin më të keq, ato që dëshirojnë të dëgjojnë apo lexojnë njerëzit, pavarësisht se sa afër realitetit janë ato që u serviren. E, për këtë arsye, fushatat zgjedhore nuk ofrojnë asgjë pozitive për elektoratin, i cili pret të dëgjojë se çfarë do të ndodhë realisht me jetën e tyre gjatë mandatit të ri qeveritar, qendror apo lokal. Faktorët e këtij skarciteti në median shqiptare janë të shumtë, por të gjitha kanë një pikë të përbashkët qendrore rreth të cilës krijojnë orbitën e tyre. Media është pushteti i katërt e, si i tillë, reflekton gjendjen e tre pushteteve të tjera (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor). Duke u nisur nga kjo bazë, atëherë, për ata që janë në dijeni të zhvillimeve politike, ekonomike e shoqërore shqiptare, kuptohet lehtësisht se pse niveli i medias në fushatë zgjedhore, por edhe në përgjithësi, është në vlera të ulta. Në një vend ku pushteti legjislativ funksionon në bazë të interesave të ngushta të deputetëve (përfundime të institucioneve të brendshme e të huaja), ku pushteti ekzekutiv shërben për të forcuar pozitat e eksponentëve të caktuar të qeverisë në pushtet e ku pushteti gjyqësor është ndër më të korruptuarit në Evropë (raporte të shumta ndërkombëtare), atëherë edhe media nuk mund t'i shmangët një gjendjeje të tillë.

## **Kontrollet mbi median**

Në të gjithë vendet në zhvillim, sidomos pas rënies së komunizmit, media ka qenë dhe vazhdon të jetë e kontrolluar nga

politika. Kjo varësi ka nivele të ndryshme sipas ritmeve të zhvillimit ekonomik të shteteve. Sa më shpejt të zhvillohet ekonomisht një vend, aq më pak ia ndjejnë nevojën e medias partitë apo politikanët; gjithçka bëjnë ata është e dukshme, ç'ka do të thotë se nuk kanë nevojë të ndërhyjnë te botuesit apo kryeredaktorët për të publikuar një veprim të tyre. Por në vende si Shqipëria, ku zhvillimi ekonomik ecën me ritme të ngadalta, madje në periudha të ndryshme kohore ka pësuar regres, politikanët kanë nevojë gjithnjë e më shumë për median. Pushteti politik, nga i cili është varur ngushtësisht edhe pushteti ekonomik në Shqipëri, “u jep të drejtën” politikanëve që të ushtrojnë një kontroll të detajuar mbi gjithçka publikohet, botohet apo shpërndalet në media. Botuesit, biznesmenë që në përgjithësi kanë nevojë për mbështetje shtetërore për sipërmarrjet e tyre, detyrohen të orientojnë politikën redaksionale në një kah të caktuar politik. Situata botues-politikan bëhet akoma më “e ngrohtë” gjatë fushatave elektorale. Para se të përcaktojnë strategjitë e tyre elektorale, stafet e kandidatëve hartojnë listën e medias që duhet t'i mbështesë. E, në këtë pikë, rol të fuqishëm kanë botuesit dhe politikanët. Dy faktorët e tjerë, shumë të rëndësishëm në fushatë zgjedhore, reporterët dhe elektorati mbeten jashtë loje. Ose më saktë, ata duhet të plotësojnë vetëm “detyrat” e tyre; reporterët të shndërrohen në radhitës të thjeshtë, ndërsa elektorati të hedhë votën e tij.

# Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA)

Instituti Demokratik Amerikan për Çështje Ndërkombëtare (National Democratic Institute for International Affairs), Partnerët për Ndryshim Demokratik (Partnerët Shqipëri), dhe Bordi Ndërkombëtar për Kërkime dhe Shkëmbime (IREX), janë Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA). Sfida përpara Shqipërisë është të adresojë korrupsionin dhe të krijojë një kulturë politike të hapur, pjesëmarrëse dhe transparente. Për ta përmbushur këtë, qytetarët duhet të organizohen për të devijuar fokusin e qeveritarëve nga përfitimet vetjake drejt një shërbimi më të mirë ndaj interesit publik. Konsorciumi DGA, i bazuar në eksperiencën e tij në Shqipëri dhe e gatshme me ide të reja, punon me kolegë shqiptarë dhe ndërkombëtarë për arritjen e këtij qëllimi.

Me mbështetjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Konsorciumi DGA ndihmon grupet civile t'i hapin dyert qeverive lokale nëpërmjet organizimit avokacisë dhe përpejkjeve vëzhguese, bordeve organizuese qytetare dhe takimeve publike. OJF-të në nivel kombëtar grupohen bashkë dhe krijojnë mekanizma të fortë për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin legjislativ. Gazetarët rrisin standardet e tyre profesionale dhe u japin qytetarëve informacionin që ata duan për të ndarë opinionet dhe u japin zë ideve të tyre. Partitë politike janë më përgjegjëse ndaj publikut, shtrirjes së qytetarëve, demokratizimit të veprimtarive të brendshme dhe nxit breza të rinj udhëheqës. Zgjedhjet shqiptare do të bëhen më demokratike kur me qindra

qytetarë të marrin pjesë në aktivitetet e planifikuara për të monitoruar procesin zgjedhor. Në të gjithë këto aktivitete, gratë janë pjesëmarrëse të dalluara, kështu që ato mund të luajnë një rol në rritje, të dukshëm dhe të rëndësishëm në jetën publike.

**CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Politikani i Ri : fletore e Akademisë për udhëheqësi  
dhe reformë politike/ përg. National Democratic Institute  
for International Affairs / Dan Redford, etj. -. -  
Tiranë : Pegi, 2005 .  
V.2, 36 f. ; 20.7  
ISBN 99943-705-4-5

324(496.5)